



Kush është çfarë në sheriat?

Description

Kush është çfarë në sheriat? – Wael B. Hallaq

Fragment i shkëputur nga libri Wael B. Hallaq, Introduction to Islamic Law (Cambridge: Cambridge University Press 2009), f. 7-14

Gjykatësit, avokatët dhe noterët janë në mënyrë të padiskutueshme produkte të profesionit ligjor në sistemet ligjore moderne. Në fillim ata edukohen në shkolla fillore dhe sekondare të akorduara nga shteti, e po ashtu edhe edukimi i tyre në shkollat ligjore, nga të cilat diplomohen më në fund, nuk i nënshtrohet më pak një akordimi të tillë. Ata studiojnë ligjet e nxjerra nga shteti, kurse në disa sisteme ligjore studiojnë gjithashtu vendimet gjyqësore të gjykatësve, të cilët në masë të konsiderueshme janë të shtrënguar prej politikave të përgjithshme të shtetit. Shkurt, profesioni ligjor është thellësisht i akorduar nga shteti dhe politikat e tij ligjore e publike. Është e vështirë të mendosh që një profesionist i ligjit të fillojë të punojë me ligjin pa qenë i detyruar të kalojë ndonjë provim të parashikuar nga shteti apo agjencitë shtetërore, dhe kur studentët e së drejtës bëhen avokatë e avokatët gjykatës, ata i referohen përfundimisht dhe pothuajse ekskluzivisht ligjit të bërë nga shteti.

Kjo situatë do të ishte e paimagjinueshme në viset muslimane para agimit të modernitetit. Fakti më befasues për sa i përket personelit ligjor tradicional islam është se ata njerëz nuk vareshin nga autoriteti i shtetit, thjesht sepse shteti siç e njohim ne sot nuk ekzistonte (në fakt nuk ekzistonte as në Evropë, ku fillimet e tij shkojnë jo më herët se në shekullin 16). Kësisoj, deri në futjen e shtetit modern në botën muslimane, gjatë shekullit 19, bashkë me institucionet e tij gjithëpërfshirëse, muslimanët rronin nën një konceptim dhe praktikë të ndryshme të qeverisjes. (Pikërisht prandaj nuk duhet të përdorim termin “shtet” për t’iu referuar asaj forme të hershme sundimi nën të cilën muslimanët jetonin para shekullit 19. Në vend të tij, për këtë lloj autoriteti do të rezervojmë terma si “sundues”, “sundim”, apo “qeverisje”.)

Sundimi musliman paramodern ishte i kufizuar, në kuptimin që nuk zotëronte pushtetet e gjera të shtetit modern. Burokracia dhe administrata shtetërore ishin të imëta, më së shumti të kufizuara në qendrat urbane dhe në masë të madhe në çështje si ushtria e sunduesit, mëkëmbësit e tij, mbledhja e taksave, dhe, rëndom, pronësia e tokës. Njerëzit nuk regjistroheshin kur lindnin, nuk kishin status

nënshtetësie, dhe mund të udhëtonin e të shpërnguleshin lirisht në troje e rajone të tjera, duke qenë se nuk kishte kufij, pasaporta, kombësi dhe ngulitje gjeografike të statusit rezidencial. Për shembull, një familje nga Kajroja mund të emigronte në Bagdad pa qenë e detyruar të aplikonte për emigrim dhe të tregonte dokumentet në kufi, sepse, siç thashë, as që kishte kufij (të paktën jo të përcaktuar saktë) apo pasaporta. Gjithashtu, sa më larg qendrës së pushtetit të jetonin njerëzit, aq më pak të ndikuar ishin nga sunduesi, ushtritë e tij dhe vullneti i tij për t'u imponuar atyre një rend të caktuar, madje dhe taksa. Arsyeja ishte e thjeshtë: për të patur kontroll të plotë mbi krahinat e largëta, sunduesit i duhej të dërgonte ushtri dhe nëpunës administrativë, shpenzimet e të cilëve jo gjithmonë do të mund të mbuloheshin nga taksat që ata do të vilnin prej popullsisë që do të kishin nën kontroll.

Pra, meqë nuk kishte një shtet për të administruar shoqërinë dhe problemet që lindnin në të, si i rregullonin njerëzit punët e tyre? Përgjigjja me një fjalë është: vetëqeverisje. Bashkësitë, qofshin në zona urbane apo në fshatra, i rregullonin vetë punët e tyre. Nëse popullsitë civile do ta ndjenin të domosdoshme të kishin një sundues, kjo ishte për shkak të nevojës specifike për mbrojtje kundër armiqve të jashtëm, qofshin këta fise plaçkitëse, banditë të organizuar rrugësh apo ushtri të huaja, të cilat mund të ushtronin dhunë e të bënin kërdrinë ndaj tyre. Por popullsitë civile nuk kishin nevojë për një sundues për të vënë rregull në çështjet e tyre të brendshme, duke qenë se një gjë e tillë sigurohej nga një sërë mekanizmash të brendshme, të zhvilluara përgjatë shekujve nga bashkësitë e tyre lokale. E drejta zakonore ishte një burim i qartë vetëmenaxhimi juridik, por sheriatu ishte po aq i rëndësishëm.

Kjo për të thënë se sheriatu nuk ishte produkt i qeverisjes islame (ndryshe nga e drejta moderne që është dukshëm produkt i shtetit). Është e vërtetë se sunduesi musliman e administronte drejtësinë duke emëruar dhe shkarkuar GJYKATESIT, madje duke përcaktuar kufijtë e juridiksionit të tyre, por ai nuk mundej kurrsesi të ndikonte në atë çka e drejta vinte në jetë dhe në mënyrën se si. Pra, pyetja që na del përpara është: nëse nuk ishte sunduesi musliman ai që e krijonte të drejtën, kush ishte? Përgjigjja është se shoqëria dhe bashkësitë e saj nxirrnin ekspertët e tyre të së drejtës, njerëz të kualifikuar për të kryer një sërë funksionesh, që, në total, përbënin sistemin ligjor islam. Tani për tani do të flasim – në mënyrë të kufizuar dhe në formën e një prezantimi – për katër kategori të njerëzve të së drejtës të cilët luanin role fundamentale në strukturimin, përpunimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të shariatit. Këta janë, MYFTIU, JURISTI AUTOR, gjykatësi dhe MJESHTRI I SE DREJTËS. Sigurisht që sistemi ligjor kishte edhe “lojtarë” të tjerë, përfshirë noterët, dëshmitarët, madje edhe sunduesin (që do të diskutohet kur t'i vijë radha), por roli i tyre në ndërtimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të sistemit nuk ishte “strukturor”, me çka dua të them se sistemi do të kishte mbetur po ai, me ose pa pjesëmarrjen e tyre. Por pa kontributet fundamentale të myftiut, juristit autor, gjykatësit dhe mjeshtrit të së drejtës, sheriatu nuk do t'i kishte tiparet e tij unike dhe nuk do të qe zhvilluar në atë mënyrë që u zhvillua. Këta katër aktorë, secili në mënyrën e vet, e bënin shariatun atë që ishte.

E fillojmë me myftiun, për arsye të rolit të tij qendror në evoluimin e hershëm të së drejtës islame dhe të kontributit të tij të rëndësishëm në lulëzimin dhe adaptueshmërinë e saj të vazhdueshme përgjatë shekujve. Myftiu, i cili kryente një funksion qendror, përfaqësonte një specialist ligjor privat që mbante përgjegjësi ligjore dhe morale karshi shoqërisë në të cilën jetonte, dhe jo karshi sunduesit e interesave të tij. Puna e myftiut ishte të lëshonte FETVA, një përgjigje ligjore ndaj një pyetjeje që i drejtohej atij. Si rregull, konsultimi me të ishte falas, që do të thotë se konsultimi ligjor ishte lehtësisht i arritshëm për të gjithë njerëzit, të pasur apo të varfër. Pyetjet që i drejtoheshin myftiut vinin nga anëtarë të bashkësisë, si dhe nga gjykatës të cilët hasnin vështirësi për të vendosur për disa çështje të sjella para tyre. Përpunimet e para ligjore që u shfaqën në Islam qenë produkte të këtij aktiviteti pyetje-përgjigje. Me kohë, këto pyetje u grumbulluan, u shumuan, u sistemuan dhe në fund u transmetuan, në kujtesë, ose

me shkrim në formën e “librave të së drejtës”.

Myftiu përcaktonte çfarë parashikonte e drejta në lidhje me një situatë të caktuar faktike. Duke qenë se, për shkak të erudicionit, atij i njihej autoritet ligjor suprem, MENDIMI i tij, ndonëse jo obligues, zgjidhte shumë mosmarrëveshje në gjykatë. E konsideruar kështu si një konstatim kompetent ligjor, *fetvaja* mbështetej dhe zbatohej rëndom në gjykatë. Një pretendues i cili nuk arrinte të merrte një *fetva* në favor të tij, zakonisht nuk i drejtohej më tej gjykatës, por e braktiste pretendimin, ose i drejtohej NDERMJETESIMIT informal.

Myftilerët nuk ishin të pranishëm vazhdimisht në gjykatë, por kjo nuk e ndryshon faktin se ata konsultoheshin rëndom për çështje të vështira, edhe nëse jetonin në distancë prej disa ditësh larg nga vendi ku shtruhej çështja. Nuk ishte e pazakontë që një gjykatës, të themi në Kajro, t'i dërgonte një letër me pyetje një myftiu i cili jetonte, fjala vjen, në Spanjë.

Autoriteti i *fetvasë* ishte vendimtar. Kur një *fetva* nuk merrej parasysh, kjo zakonisht ndodhte sepse një tjetër *fetva*, shpesh e sjellë nga një palë oponente, paraqiste një mendim më bindës dhe të arsyetuar më mirë. Shprehur ndryshe, ishte rast i rrallë që një gjykatës të mos e merrte parasysh një mendim kundrejt mendimit të vet, veç në rast se vetë gjykatësi ndodhte të ishte i një kalibri juridik më të lartë se myftiu të cilit i qe lypur *fetvaja* (në të cilin rast gjyqtari që në fillim nuk do të kërkonte *fetva*). E gjitha kjo për të thënë se *fetvaja* ishte produkt i një kompetence dhe njohurie të përparuar ligjore, dhe sa më i ditur të ishte myftiu, aq më me autoritet dhe e pranueshme ishte *fetvaja* e tij, si për gjykatën ashtu dhe për publikun. (Niveli i njohurisë ligjore të një dijetari përcaktohej nga përvoja, dhe jo nga gradët apo diplomat. Kuti i një juristi të spikatur ishte, veç të tjerash, cilësia e teksteve dhe e *fetvave* të tij, si dhe aftësia për të fituar në debate akademike me dijetarë të shquar.)

Roli qendror i *fetvasë* në gjykatën muslimane shpjegon arsyen pse vendimet e gjykatësve nuk ruheshin dhe as publikoheshin, ashtu siç veprohet në gjykatat moderne. Me fjalë të tjera, ligji nuk themelohej mbi precedentët e ngulitur nga gjykatat (nacioni i bazuar mbi doktrinën STARE DECISIS), por mbi një akumulim jurisprudencial tekstesh që e kishte origjinën kryesisht në përgjigjet e dhëna nga myftilerët.

Në këtë mënyrë, jo vendimet gjyqësore, por *fetvatë*, të cilat buronin nga praktikat ligjore, mblidheshin dhe publikoheshin, mes tyre veçanërisht ato që përmbanin ligje të reja ose që ofronin përpunime të reja ligjore për probleme të vjetra që vazhdonin të mbeteshin të vlefshme. Të tilla *fetva* zakonisht i nënshtroheshin një procesi të rëndësishëm redaktorial, gjatë të cilit liheshin jashtë fakte pa peshë ligjore dhe detaje personale (si emrat e personave, emrat e vendeve, datat, etj.). Për më tepër, ato përmbledheshin me qëllimin për ta abstraguat përmbajtjen e tyre në formula rigorozisht ligjore, zakonisht të llojit hipotetik: “Nëse X në disa kushte të caktuara bën Y, atëherë rrjedh N (NORMA LIGJORE).” Pasi redaktoheshin dhe përmbledheshin, këto *fetva* bëheshin pjesë e literaturës ligjore autoritative, për t’iu referuar dhe për t’u zbatuar siç e kërkonte rasti.

Megjithatë, pjesa më e madhe e punimeve ligjore islame nuk janë shkruar nga myftilerët, por nga juristët autorë, të cilët në masë të madhe mbështeteshin në *fetvatë* e myftilerëve më të spikatur. Veprimtaria e juristëve autorë shtrihej nga shkrimi i trajtesave të shkurtra, por të specializuara, deri në hartimin e veprave më të gjata, të cilat zakonisht përbëheshin nga komentime të zgjeruara të punimeve të shkurtra. Kështu, një trajtesë e shkurtër që përmbledhete të drejtën në tërë diapazonin e saj vinte zakonisht në dyqind faqe, e shpesh prodhonte komentime që arrinin gjer në dhjetë, njëzet, apo tridhjetë vëllime. Ishin këto vepra që u jepnin juristëve autorë mundësinë për të artikuluar, secili për

brezin e vet, një korpus ligjesh që reflektonin si kushtet e evoluara shoqërore, ashtu dhe mjeshtërinë më të lartë për kohën në të drejtën si disiplinë teknike. Shqetësimi kryesor i juristëve autorë ishte përfshirja e çështjeve ligjore (në pjesën më të madhe *fetva*) që ishin bërë relevante dhe të domosdoshme për kohën në të cilën shkruanin. Kjo dëshmohet me këmbënguljen e palodhur në domosdoshmërinë e përfshirjes në veprat e tyre të “çështjeve shumë të nevojshme ligjore”, të vlerësuara si relevante për nevojat e kohës, si dhe të çështjeve “me hasje të dendur”.¹ Nga ana tjetër, çështje që ishin bërë jorelevante për bashkësinë dhe nevojat e saj, duke dalë kështu nga qarkullimi, lireshin jashtë. Shumë, në mos shumica e rasteve të përfshira, vërtetoheshin se u përkisnin “jurisprudentëve të vonë”, të cilët i kishin përpunuar ato për t’iu përgjigjur problemeve të reja të shfaqura në bashkësi. Duke reflektuar në shkrimet e tyre “kushtet e ndryshuara të njerëzve dhe të kohës”², juristët autorë parapëlqenin mendime më të vona, që shpesh nuk përputheshin me doktrinat e mjeshtërive më të hershëm. Po ashtu, ndriçues është fakti se *fetvatë* që përbënin thelbin e doktrinave të mëvonshme ishin ato që u përgjigjeshin nevojave të kohës dhe që në të njëjtën kohë kishin fituar vlefshmëri në zbatim. Nga ana tjetër, mendime që kishin reshtur së përdoruri në çështje gjyqësore përjashtoheshin si të dobëta, madje edhe të parregullta.

Një pjesë e mirë prej veprave të shkruara dhe të “publikuara” nga juristët autorë shërbenin si referenca standarde për gjykatësit, të cilët i studionin ato kur ishin studentë dhe i konsultonin pasi emëroheshin në gjyqësor. Kësisoj, meqë autoriteti i së drejtës mbështetej në mendimet e myftiut dhe në trajtesat e juristit autor, gjykatësi, për sa kohë nuk ishte edhe vetë myfti dhe/ose jurist autor njëkohësisht, nuk pritej të zotëronte të njëjtin nivel njohjeje të kualifikuar ligjore. Kjo do të thotë se një myfti apo jurist autor mund të ushtronte zakonisht funksionin e gjykatësit, kurse një gjykatës i edukuar vetëm si i tillë nuk mund të shërbente në kapacitetin e myftiut, e as të juristit autor.

Eshtë e qartë se puna e një gjykatësi është gjykimi i mosmarrëveshjeve, çka në fakt është detyra kryesore e një gjykatësi modern. Por kjo ishte vetëm njëra nga shumë detyra të rëndësishme që gjykatësi musliman, KADIU, ishte i detyruar të merrte përsipër. Kadiu, ashtu si myftiu, ishte anëtar i bashkësisë së cilës i shërbente. Në fakt, vetë e drejta islame këmbëngul që kadiu, për t’u kualifikuar si i tillë, është i detyruar t’i ketë njohur nga afër zakonet lokale dhe mënyrën e jetesës në bashkësinë së cilës i shërben. Me ndihmën e stafit të tij (që do ta diskutojmë shkurtimisht kur t’i vijë radha), ai ngarkohej me mbikëqyrjen e shumë aspekteve në jetën e bashkësisë. Ai mbikëqyrte ndërtimin e xhamive, të rrugëve, të çezmave publike dhe të urave. Inspektonte godinat e sapondërtuara, funksionimin e spitaleve dhe të kuzhinave vorfnore, si dhe kontrollonte, veç të tjerash, tejet të rëndësishmet VAKËFE. Vëzhgonte nga afër përkujdesjen e kujdestarëve për jetimët dhe të varfrit, dhe vetë merrte përsipër rolin e kujdestarit në martesat e grave të cilat nuk kishin të afërm meshkuj. Veç kësaj, kadiu shpesh luante rolin ekskluziv të ndërmjetësit në rastet që nuk ishin të një natyre rigorozisht ligjore. Jo vetëm që ndërmjetësonte e arbitronte mosmarrëveshjet dhe arrinte pajtime midis bashkëshortëve, por gjithashtu dëgjonte, fjala vjen, problemet që përçanin vëllezër të cilëve nuk u nevojitej më shumë se mendimi i një të jashtmi.

Veç kësaj, gjykata muslimane ishte vendi ku regjistroheshin veprime të rëndësishme midis individëve, si shitja e një shtëpie, hollësitë e pronës së një personi të vdekur, apo një kontratë ortakërie midis dy tregtarëve. Herë pas here dikush mund t’i drejtohej gjykatës thjesht për t’i kërkuar të mbante shënim një fyerje që i ishte bërë prej dikujt tjetër, në kuadër të ndërtimit të një “historie” në rast të një konflikti që mund të lindte në të ardhmen me personin në fjalë.

Po aq i rëndësishëm ishte ambienti shoqëror në të cilin funksiononte kadiu dhe gjykata. Gjykatësit

përpiqeshin gjithmonë të kuptonin kontekstin më të gjerë shoqëror të palëve në gjyq, e shpesh tentonin t'i zgjidhnin konfliktet duke marrë në konsideratë në mënyrë të plotë marrëdhëniet aktuale dhe të ardhshme shoqërore të palëve. Ashtu si ndërmjetësit, por jo si gjykatësit modernë, kadilerët përpiqeshin fort, sa herë që ishte e mundur, për të parandaluar rrënimin e marrëdhënieve, në mënyrë që të ruanin një realitet shoqëror në të cilin palët në konflikt, që shpesh i përkisnin të njëjtës bashkësi, të mund të vazhdonin të bashkëjetonin miqësisht. Një veprim i tillë gjyqësor kërkonte që kadiu ta njihte historinë e marrëdhënieve mes palëve dhe të ishte i gatshëm ta hetonte atë.

Së fundmi, na takon të themi disa fjalë për mjeshttrin e së drejtës. Fillimet e edukimit ligjor në Islam mund të gjurmohen deri tek myftilerët e shfaqur gjatë dy apo tre dekadave të fundit të shekullit 7 si specialistë privatë të së drejtës. Ata nuk merrnin rrogë, dhe interesi i tyre për studimin e së drejtës motivohej nga përkushtimi fetar dhe nga dëshira për nxënie fetare. Rreth secilit prej këtyre myftilerëve të hershëm mblihdeshin një numër nxënësish, e nganjëherë kureshtarë të sferës intelektuale, të cilët ishin të interesuar për të fituar njohuri nga Kur'ani dhe nga biografia e Profetit Muhammed si një standard shembullor jetese. Këto grumbullime ndodhnin zakonisht në xhamitë e reja të ndërtuara në qytetet e ndryshme që qenë përfshirë nën sundimin e Islamit. Duke ndjekur traditën e këshilleve fisnore të arabëve kur mblihdeshin për të diskutuar çështje me rëndësi, këto grumbullime studimore morën formën e RRETHEVE, ku myftiu/mjeshtri ulej përtokë, këmbëkryq, me studentët dhe të interesuarit të cilët uleshin në formë rrethi, në të djathtë e në të majtë të tij. (Kjo po ashtu ishte forma fizike në të cilën zhvilloheshin edhe seancat gjyqësore.) Nxënësit nuk ishin të detyruar të aplikonin formalisht për të studiuar me një mjeshtër, ndonëse miratimi i tij informal për përfshirjen e tyre në rrethin e tij ishte i nevojshëm zakonisht, siç ishte dhe sjellja e duhur nga ana e nxënësit. Nuk paguhej ndonjë tarifë, përveç dhuratave që mund t'i bëheshin mjeshtrit nga nxënësit ose familjet e tyre. Me përfundimin e studimeve nuk jepej ndonjë diplomë apo gradë shkencore, por vetëm një dëshmi nga mjeshtri, që vërtetonte se nxënësi kishte përfunduar studimin e një libri, të cilin nga ana e tij mund t'ua transmetonte ose mësonte të tjerëve. Dëshmia në fjalë ishte personale dhe mbartte autoritetin e vetë mjeshtrit, dhe jo të një institucioni jopersonal (siç janë dëshmitë që jepen nga universitetet e sotme).

Dallimi mes një kuvendi fetvadhënieje dhe një rrethi studimor nuk ishte gjithmonë i prerë ose i qartë gjatë dy shekujve të parë të Islamit. Në fakt, kjo situatë vazhdoi të mbetej në njëfarë mase e ngjashme edhe gjatë shekujve të mëvonshëm, kur një myfti i ulur në mes të rrethit deklaronte fundin e një seance *fetvaje* dhe hapjen e një seance tjetër për gjykimin e çështjeve, në rolin e gjykatësit, dhe ndoshta në mbrëmje (ndonjëherë pasi kishte ngrënë darkë bashkë me nxënësit) hapte një tjetër rreth për mësimdhënie. (Shpesh lexojmë në burime se shumë JURISTE i shkruanin trajtesat e tyre ligjore gjatë orëve të natës, në veçim, duke vepruar kështu në kapacitetin e juristit autor. Duhet thënë se ata të cilët vepronin në të katër kapacitetet konsideroheshin zakonisht si ndër juristët më të kualifikuar.)

Disa nga *fetvatë* e hasura në një seancë fetvadhënieje mund të diskutoheshin në rrethin studimor, ndërkohë që disa nxënës që merrnin pjesë në rrethin studimor ose fetvadhënës, mund të shërbenin si dëshmitarë kur rrethi kthehej në seancë gjyqësore. Në këtë mënyrë, këto tre aktivitete apo sfera, ndërkohë që ishin të ndryshme nga njëra-tjetra, ndërthureshin në shumë forma, si në nivelin e pjesëmarrjes studentore, ashtu dhe në atë të mjeshtrit. Një person i cili ishte myfti mund të jepte mësim dhe, pa dyshim, ishte i kualifikuar për të kryer detyrën e gjykatësit (sigurisht, pasi të qe emëruar si kadi nga sunduesi apo guvernatori).

Si të emëruar nga shteti, gjykatësit shpërbleheshin financiarisht prej sunduesit për punën e tyre, por kjo nuk vlente për myftilerët apo për mjeshttrat (me përjashtim të praktikës së mëvonshme OSMANE, të

cilën do ta diskutojmë kur t'i vijë radha). Megjithatë, edhe gjykatësit nuk i gëzonin këto emërime me kohë të plotë gjatë katër apo pesë shekujve të parë të Islamit, e, kur nuk i kishin, ishin të detyruar të gjenin burime të tjera të ardhurash, si myftilerët dhe mjeshtrat. Kjo do të thotë se juristët muslimanë, sado të mësuar e të aftë të ishin në të drejtën, për sa i përket sigurimit të jetesës nuk ishin profesionistë ligjorë me kohë të plotë deri në institucionalizimin e profesionit ligjor. Kështu, gjer në shekullin 11 apo 12 shumica dërrmuese e juristëve kryenin punë të tjera, një pjesë e mirë e tyre si lëkurëpunues, rrobaqepës, kovaçë, kopjues dorëshkrimesh ose shitës e tregtarë. Me fjalë të tjera, ata u përkisnin zakonisht atyre të cilët sot i quajmë shtresa të ulëta e të mesme, e jo shtresave të larta

Perktheu: Rubin Hoxha

Referenca

[1](#) Wael Hallaq, *Authority, Continuity and Change in Islamic Law* (Cambridge: Cambridge University Press, 2001), 188-189.

[2](#) Po aty.

Date Created

04/05/2017

Author

wael-hallaq